



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2369/4 prot.

Datë 05.10.2023

V E N D I M

Nr. 989 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.10.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. 2369/2023 prot., datë 27.09.2023 e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-80868-09-21-2023, me objekt “*Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit per objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a*” me fond limit 32.253.174,3 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH SHA.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Silver” SHPK me NIPT K88010301S dhe adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Bajram Curri”, Pallatet 1 Maji, Godina nr.7, Shkalla 4, Kati 1- rë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH SHA me adresë: Rruga “Reshit Petrela”, Përballë Dispanserisë, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 22.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80868-09-21-2023, me objekt “*Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a*” me fond limit 32.253.174,3 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH SHA.

II.2. Në datën 27.09.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është paraqitur ankesa me nr. 2369/2023 prot., datë 27.09.2023 e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Me anë të shkresës nr.112 prot., datë 03.10.2023 me objekt “Kërkesë për heqje dorë nga ankesa”, protokolluar pranë KPP-së me nr.2369/2 prot., datë 03.10.2023, operatori ekonomik “Silver” SHPK njofton se: *“...Nëpërmjet kësaj kërkesë bazuar në Ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, deklaroj dhe kërkoj heqjen dorë nga ankesa”*.

II.4. Me anë të shkresës nr.3462/2 prot., datë 02.10.2023, protokolluar me tonën me nr.2369/2 prot., datë 03.10.2023, autoriteti kontraktor na vë në dijeni në lidhje me aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Silver” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-80868-09-21-2023, me objekt *“Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH sh.a dhe objektet në administrim të FSHU sh.a”* me fond limit 32.253.174,3 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH SHA, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. 2369/2023 prot., datë 27.09.2023 të operatorit

ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-80868-09-21-2023, me objekt *“Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a”* me fond limit 32.253.174,3 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH SHA.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Silver” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri